



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:167606

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05507702

KPPP.nr.1219/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përbarimore të kreditorit “SIA PLAST” L.L.C., me adresë në Pejë rruga Zagermë pn, me NUI: 811917882, kundër debitorit “ARBËRIA” Sh.P.K., me adresë në Prishtinë, me NUI: 810 ,m505729, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.110/23 të datës 04.07.2023, të nxjerrë nga Përbaruesi Privat Jeton Krasniqi me seli në Pejë, jashtë seancës me datë 25.03.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET NË TËRËSI i pabazuar prapësimi i debitorit “ARBËRIA” Sh.P.K., i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.110/23 të datës 04.07.2023, të nxjerrë nga Përbaruesi Privat Jeton Krasniqi, dhe i njejti Urdhër MBETET NË FUQI në tërësi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, me Urdhrin Përbarimor P.nr.110/23 të datës 04.07.2023, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, e ka caktuar përbarimin ndaj debitorit në bazë të dokumentit të besueshëm–faturës nr.030323001-1 të datës 03.03.2023 (në shumën prej 1,828.38 Euro), me të cilin ka urdhëruar që të debitohen/bllokohen të gjitha llogaritë bankare të debitorit që i ka të hapura në bankat komerciale të Republikës së Kosovës, të vihen ndalesa/ngrirja në pasurinë e luajtshme që i ka debitori, dhe të kryhet procedura e shiqimit, regjistrimit, inventarizimit, e konfiskimit të pasurisë së luajtshme që ka në pronësi dhe posedim debitori. Kjo procedurë të

kryhet konform Ligjit të Procedurës së Përmbartimit, deri tek lartësia e borxhit që ka rrjedh nga fatura e lartpërmendur, sipas nenit 29 par.1 nën par.1.3 të LPP-së.

Kundër urdhrin të Përmbartuesit Privat, debitori ka ushtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor, me arsyetimin se faturat janë të panjohura, dhe nuk posedojnë vulën dhe nënshkrimin e personit përgjegjës. Ka theksuar se sipas ligjeve të Kosovës një urdhër përmbartimor mund të ekzekutohet kur plotësohen disa kushte si vula dhe nënshkrimi, e që në këtë rast nuk janë në dokumentet e kreditorit “SIA PLAST” L.L.C.

Kreditori në përgjigje në prapësim, ka theksuar se faturat janë pranuar dhe nënshkruar nga punëtorët e kompanisë-debitorit, dhe se i njëjti ka pozitën e depoistit për pranim të materialit apo mallit, me të cilin kemi furnizuar, dhe për këtë marrëdhënie kontraktuese i kemi edhe provat me të cilat kemi komunikuar lidhur me këtë borxh të papaguar të debitorit. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi prapësimi dhe të lihet në fuqi urdhri i Përmbartuesit Privat.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit është i pabazuar dhe duhet të refuzohet në tërësi nga shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërkaq me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*. Tutje me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm, sipas të cilit mund të caktohet përmbartimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në shkresat e lëndës është evidentuar se kreditori i ka bashkëngjitur propozimit për përmbartim dokumentin e besueshëm faturën nr.030323001-1 të datës 03.03.2023, në origjinal dhe me të gjitha elementet përmbajtësore të cilat i përcakton LPP me nenin 29 dhe 37.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura nr.030323001-1 e datës 03.03.2023, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP-së, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që në këtë faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, është përcaktuar koha e përmbushjes së detyrimit, e njejta është dorëzuar në origjinal dhe është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, fakt ky i cili vërtetohet me nënshkrimin e debitorit.

Andaj, bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1219/23, me datë 25.03.2024

Gj y q t a r i

Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Dhomen e Shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale të Kosovës me seli në Prishtinë.